



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.25, datë 08.11.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMIN E
IMPIANTIT FOTOVOLTAIK “SUNNY SIDE ENERGY”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 100MW, VEPRAVE NDIHMËSE DHE LINJA E TRANSMETIMIT” ME
VENDNDODHJE NË DARZEZË, BASHKIA FIER.

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimin e impiantit fotovoltaik “Sunny Side Energy”, me kapacitet të instaluar 100 MW, veprave ndihmëse dhe linja e transmetimit”, me vendndodhje në Darzezë, Bashkia Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËRI I LINJËS
MINISTËRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31/12/2024